



REPUBLIKA E SHQIPËRIË  
MINISTRIA E KULTURËS  
KËSHILLI KOMBËTAR I RESTAURIMEVE

VENDIM

Nr. 14, dt. 08.01.2016

Në mbështetje të nenit 47 të ligjit nr. 9048, datë 07.04.2003, “Për Trashëgiminë Kulturore”, i ndryshuar, Këshilli Kombëtar i Restaurimeve, në mbledhjen e datës 08.01.2016, pasi shqyrtoi projektin e diskutuar më parë dhe në Këshillin Shkencor të Institutit të Monumenteve të Kulturës,

VENDOSI:

1. Miratimin e projektit për ndërtimin e depozitave të hidrokarbureve, gazoil, benzinë, solar me kapacitet 12.200 m<sup>3</sup>, në zonën energjitike dhe industriale të Porto Romanos, Bashkia Durrës, me subjekt kërkues shoqërinë “Tirana Bank” sh.a.
2. Gjatë procesit të zbatimit të projektit për ndërtimin e depozitave të hidrokarbureve në Porto Romano, siç parashikon dhe legjislacioni për trashëgiminë kulturore, punimet të mbikqyren sipas nenit 48 të ligjit nr. 9048, datë 07.04.2003, “Për Trashëgiminë Kulturore”, i ndryshuar.
3. Ngarkohet Sekretaria Teknike për njoftimin e këtij vendimi.  
Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

KRYETAR

MIRELA KUMBARO FURXHI



SEKRETAR I KKR

ARTA DOLLANI